



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 51 , datë 14.05.2020

“PËR

**NJË SHITESË DHE DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.157, DATË
26.12.2019, TË KËSHILLIT BASHKIAK “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT
BUXHETOR AFATMESËM 2020-2022 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË
BASHKISË SË TIRANËS PËR VITIN 2020”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpikat 1.1 shkronja “b”, pika 1.3 shkronja “c” nenit 41, pika 1, neni 54, shkronja “dh”, nenit 55, pikat 3 dhe 6 të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 113 të Ligjit nr.44/2015, datë 30.04.2014 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 88/2019 “Për Buxhetin e vitit 2020”; nenit 43 dhe nenit 44 të Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimit plotësues nr.2 datë 20.01.2020 të Ministrit të Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 të Ministrit të Financave për “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të vendimit nr.202 datë 05.03.2020 të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rindërtimit të banesave individuale”,(indryshuar); të vendimit nr.374 datë 06.05.2020 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në vendimin nr. 202, datë 05.03.2020 të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rindërtimit të banesave individuale”; të vendimit nr. 375, datë 06.05.2020 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në vendimin nr. 307, datë 16.04.2020 të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rikonstruksionit dhe rindërtimit të infrastrukturës publike në funksion të rindërtimit të banesave individuale dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese”(i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,


V E N D O S I:

Në vendimin nr.157, datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020”, bëhet ky ndryshim:

1. Të miratojë ndryshimin e emërtimit të objektit sipas pasqyrës nr.1 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Të miratojë detajimin e shtesës së fondeve të rindërtimit të akorduara në formën e transfertës së pakushtëzuar në kuadër të procesit të rindërtimit brenda programit të Strehimit Lokal dhe Urbanistikës, Shërbimeve Publike Vendore dhe Arsimit Bazë përfshirë dhe arsimin Parashkollor sipas pasqyrës nr.2, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NjA dhe Emergjencave Civile, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit Ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

KRYETAR

TONI GOGU

